



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 7 NËNTOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 7.
NOVEMBRA 2008. GODINE

NËNTOR - NOVEMBAR

2008

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i parë i Grupit të shtatë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nr. 03-L-045,
- 1.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nr.03-L046,
- 1.3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 2003/14, dhe
- 1.4 Shqyrtimi i parë i Projekt-Kodit doganor dhe të akcizave të Kosovës.

D n e v n i r e d:

1. Prvo razmatranje sedme Grupe nacarta zakona iz Predloga Martti Ahtisaarija, po posebnom postupku:

- 1.1. Prvo Razmatranje Nacrta Zakona o izmenama Zakona o Ministarsvo bezbedonosnih snaga Kosova, br. 03-L-045,
- 1.2. Prvo Razmatranje Nacrta Zakona o izmenama Zakona o bezbedonosnim snagama Kosova, br. 03-L-046,
- 1.3. Pvro razmatranje Zakona o prostornom planiranju, br. 2003/14, i
- 1.4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o carini i akcize na Kosovu.

A g e n d a:

1. First reading of the seven't Group of the Draft Laws from the Martti Ahtisaari's Proposal, based on the Special procedure:

- 1.1. First reading of the Draft law on amendment of the Law on Ministry of Kosovo Security Force, no. 03-L-045,
- 1.2 First reading of the Draft law on amendment of the Law on Kosovo Security Force, nr.03-L046,
- 1.3. First reading of the Draft law on amendment of the Law on Spatial Planning, nr. 2003/14, and
- 1.4 First reading of the Draft-Code of Kosovo Customs and Excise.

Seancën e kryesoi, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme të veçantë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë 76 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin të ndërlidhur me të sipas procedurës së veçantë, të datës 15 shkurt 2008, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 7 nëntor 2008 ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendi i ditës, së bashku me materialet iu është shpërndarë deputetëve.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin. E ka fjalën ministri Arsim Bajrami.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

Në mungesë të ministrit të resorit përkatës, do t'ju ftoj që sot të votoni në parim propozimin për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë dhe të njëjtin propozim të Qeverisë ta procedoni sipas mocionit të miratimit të ligjeve me procedurë të përshpejtuar, sepse edhe ky ligj bën pjesë në grupin e ligjeve që kanë të bëjnë me implementimin e Pakos së Ahtisarit.

Ndryshimet që i ka aprovuar Qeveria nuk prekin esencën e ligjit. Janë gjithsej 2 amendamente dhe ne do të mirëpresim që ky Ligj t'i procedohet grupit ad-hoc për shqyrtimin e këtij ligji dhe me një procedurë të përshpejtuar t'i prezantohet për miratim në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e kanë shefat e grupeve parlamentare. Duhet të shkojmë ligj për ligj. E ka fjalën Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar!

Meqë e dimë të gjithë bashkë procedurën se si shkon, atëherë nuk kemi nevojë të bëjmë stërzgjatje të kësaj procedure. Ne, si Grup Parlamentar, e mbështesim këtë procedurë të përshpejtuar dhe ta realizojmë atë që është më së miri për kohën që kërkohet.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

E ka fjalën deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së i mbështet ndryshimet e propozuara nga Qeveria me qëllim që të harmonizohet Ligji me Kushtetutën e Republikës dhe po ashtu e mbështet edhe procedurën sipas mocionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, e ka fjalën deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Nuk na mbetet asgjë tjetër përpos të pajtohemi me ato të cilat i kemi vendosur kaherë vetë me mocionin. Po ashtu, këtu do të jepja një vërejtje. Me kalimin e këtyre ligjeve, të cilat ne i kemi pasur deri tash, e që burojnë nga Pakoja e Presidentit Ahtisari dhe ,në mungesë të një debati, po shihet se kemi pasur gabime në hapa, sepse ne, pa kaluar disa muaj, detyrohemi që të ndryshojmë ligjet të cilat ky Parlament me procedura të shpejta i ka miratuar. Natyrisht, si Grup Parlamentar jemi në favor të asaj që këto të harmonizohen tashmë me Kushtetutën dhe do të kemi miratimin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, e ka fjalën deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për këtë ligj edhe Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet edhe procedurën dhe e voton projektligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e ka fjalën deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim miratimin e ndryshimit të Projektligjit për Forcën e Sigurisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Në emër të Grupit “7+”, e ka fjalën deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MEXHA: Faleminderit, zotni Kryetar!

Edhe Grupi “7+” e mbështet këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, kalojmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 “abstenime”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’i paraqet Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e dytë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami, të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe ndryshimi i këtij Ligji bëhet për motive të njëjta dhe me qëllim që Ligji të përshtatet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këto ndryshime, në fakt, do ta kompletojnë këtë materie të domosdoshme që del edhe si detyrim i implementimit të Pakos së Ahtisarit, andaj ju ftoj ta përkrahni në parim dhe të procedohet me procedura të shpejta.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! A dëshirojnë shefat e grupeve parlamentare të thonë diçka lidhur me këtë? S’jeni lajmëruar. Atëherë shkojmë në procedurë të votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Faleminderit! Konstatohet se me 72 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 “abstenime”, Kuvendi miratoi Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në parim.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e ardhës t’i paraqet Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e radhës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor

Ftoj ministrin e Bujqësisë, zotin Idriz Vehapi, që ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe ky Ligj i përket grupit të shtatë të projektligjeve nga propozimi i Marti Ahtisarit dhe ndryshimet të cilat janë në këtë ligj, janë kryesisht terminologjike. E thërras Kuvendin që

me procedurë të përshpejtuar ta miratojë në parim këtë ligj dhe ta procedojë më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Shefat, nuk janë lajmëruar për fjalë. Atëherë kalojmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 5 “kundër”, 12 “abstenime”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’i paraqes Kuvendit raportin me rekomandimet.

Tani, në sallë kemi 82 deputetë.

Pika e katërt dhe e fundit e rendit të ditës, është:

- Shqyrtimi i parë i Projektkodit doganor dhe akcizave të Kosovës

Ftoj ministrin për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala, të prezantojë Projektligjin para Kuvendit.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Kam kënaqësi dhe privilegj të veçantë që sot të paraqes para jush Projektligjin për Kodin doganor dhe të akcizës.

Ky ligj është në fazën përfundimtare të transferimit të kompetencave, të fundit në lëmin e ekonomisë, nëse mund të them, dhe të kontrollit të kufirit nga UNMIK-u në organet e Kosovës, përkatësisht në Qeverinë e Kosovës.

Në vazhden e bartjes së kompetencave, ky Ligj pothuaj se bën në mënyrë organike zgjidhjen e problemeve të cilat deri më tash kanë qenë një ndër të metat kryesore të rregulloreve të UNMIK-ut të cilat janë zbatuar dhe të cilat mbase janë identifikuar edhe nga vetë Qeveria e Kosovës dhe institucionet përcjellëse me disa të meta.

Draftkodi i doganës dhe akcizës, që tash është para jush, është një rezultat i punës së ekspertëve vendorë të doganës dhe të atyre ndërkombëtarë, sidomos me KFN, me Komisionin Evropian, me administratën tatimore dhe me organet e tjera të rëndësishme në Kosovë.

Ndryshimet në draftkod janë bazuar në bartjen e përgjegjësi nga UNMIK-u, siç ishte në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/1, në Qeverinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, siç është paraparë me draftkodin që e keni përpara.

Pjesa për emërtimin e drejtorit gjeneral të doganës në fazën kalimtare, është e harmonizuar me aneksin 9, neni 2, paragrafi 2 pika d) të Pakos së Presidentit Ahtisari dhe më pas është inkorporuar edhe aneksi V i Ahtisarit për lirim nga detyrimet importuese doganore të kishës ortodokse serbe, siç është paraparë me këtë aneks.

Në dispozitat për organizimin e doganës është vendosur baza për zhvillimin e një dogane shumë efektive që do të përfitojnë subjektet afariste të tregtisë së jashtme, Qeveria e Republikës së Kosovës, por më së shumti qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pjesa tjetër është e harmonizuar me Rregulloren e Këshillit Evropian Numër 2913, të vitit 1992, të datës 12 tetor 1992, me direktivat e fundit të Bashkësisë Evropiane të cilat nuk kanë qenë të inkorporuara në Kodin doganor, përkatësisht në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/1, e cila është deri më tani në fuqi.

Me këtë draftkod janë plotësuar mangësitë dhe paqartësitë të cilat kanë ekzistuar po ashtu në Kodin doganor në fuqi me instrumentet e tij, ku importuesit tani nëpërmjet procedurave të thjeshtësuara dhe procedurave me ndikim ekonomik shumë më lehtë do të posedojnë me mallin. Natyrisht, për doganën ekzistojnë edhe obligimet dhe përgjegjësitë që përmes fuqisë që është dhënë me këtë kod të ushtrojnë kontrollin në subjektet importuese të afarizmit të tregtisë së jashtme. Për ato subjekte të cilat nuk i përfillin dispozitat e këtij kodi, oficerët doganorë tanimë do të ndërmarrin në bazë të ligjit masa sanksionuese dhe masa të tjera ligjore për t'i eliminuar shkeljet dhe keqpërdorimet, të cilat ishin mungesë në rregulloret e deritashme.

Ankesat e lirimit, të cilat janë të bashkangjitura me këtë kod, janë lirimet të cilat janë në fuqi me urdhëresat administrative të UNMIK-ut 2004/24, me përjashtim të pajisjeve të cilat janë përdorur për prodhim jashtë Kosovës dhe nëse titullari i këtyre pajisjeve vendos të zhvendosë, përkatësisht të bartë biznesin e tij apo veprimtarinë e tij prodhuese në Kosovë, do të gëzojë të drejtën e lirimit nga detyrimet importuese doganore. Një pozicion shumë i rëndësishëm për zhvillimet ekonomike në Kosovë.

Më duhet cekur se në këto anekse janë plotësuar edhe zbrazësitë të cilat kanë ekzistuar në urdhëresat administrative të UNMIK-ut sa i përket procedurës së dhënies së lirimit. Tani kjo është në përputhje me direktivën e Bashkësisë Evropiane për lirimin nga detyrimet doganore të vitit 1983 me ndryshimet e mëvonshme.

I nderuari Kryetar,

Të nderuar të pranishëm,

Përveç asaj që u tha deri më tani, është edhe kërkesë e Komisionit Evropian për dogana dhe tatime që nëpërmjet dokumentit të kaltërt, të ashtuquajtur Cartoons blueprint të ripërtërihet në legjislacionin doganor të Kosovës. Andaj, draftkodi që është propozuar para jush dhe i cili ka kaluar edhe nëpër filtra tjerë të grupit gjithëpërfshirës dhe të grupit

strategjik, i plotëson të gjitha kërkesat për të qenë në harmoni me kërkesat e Komisionit Evropian për doganat dhe tatimet dhe doganat të jenë më efikase në gjithë territorin e saj.

Kërkoj nga ju që ta përkrahni dhe ta adaptoni e ta votoni. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, por unë jo!

KRYETARI: Nëse jo, atëherë, fjalën e ka kërkuar deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot po miratojmë një pjesë të pakove të ligjeve, të cilat Kuvendi i Kosovës ka marrë si obligim t'i adresojë në kohë. Por, të nderuar deputetë, sot krijohet edhe një obligim shtesë për institucionet e vendit, sidomos kur kemi në konsideratë gjendjen aktuale në një pjesë të territorit të Kosovës dhe sidomos kur bëhet fjalë për mosfunksionimin e doganave në atë pjesë. Prandaj, deri sot ne tash për tash nuk kemi pasur rastin që të njoftohemi me përmbajtjen e këtij dokumenti dhe është obligim i Qeverisë së Republikës së Kosovës që para këtij Kuvendi deputetët e Kuvendit të Republikës t'i sigurojë se ky projekt nuk cenon funksionalitetin e doganave të Republikës së Kosovës dhe ky dokument – projekt është në përputhje me interesat strategjike të shtetit të pavarur të Kosovës.

Prandaj, këtu nuk dëshirojmë që në asnjë mënyrë t'iu ikim përgjegjësi si deputetë, por Qeveria e Kosovës, me dy fjalë, të prononcohet para këtij Kuvendi në mënyrë që edhe ne, edhe qytetarët e Kosovës të ndihemi shumë më të qetë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka kërkuar Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Sa për sqarim, për shkak që besojmë se nuk kemi pasur kohë të mjaftueshme për ta kuptuar se për çka po votojmë, është një ligj voluminoz, një Projektligj për të cilin nuk kemi pasur dijeni ose nuk kemi dijeni të sakta se çka përmban, Grupi Parlamentar i AAK-së përmbahet prej votimit të këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shefat e grupeve të tjera parlamentare, nuk janë lajmëruar për fjalë. Shefat e grupeve, lexoni mocionin!

Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 38 vota “për”, 6 “kundër”, 12 “abstenime”, miratohet në parim Projektkodi doganor dhe i akcizave të Kosovës.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t'i paraqet Kuvendit raporte me rekomandime.

Të nderuar deputetë,

Para se ta jap një njoftim, dëshiroj që ministrave të Kabinetit qeveritar tua tërheq edhe njëherë vërejtjen, besoj edhe në emrin tuaj, që seancat plenare për Qeverinë dhe për ministrat janë obligim kryesor dhe nuk mund të ketë detyrë tjetër më kryesore se prezenca e tyre në seancë dhe unë nuk dëshiroj që Kuvendi të shtyjë pikat e rendit të ditës për shkak të mungesës së papërgjegjshme, të them kështu, të disa ministrave.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se seanca e ardhshme për të shqyrtuar në lexim të dytë ligjet që i miratuam sot, do të mbahet të hënën, në orën 11:00. Për këtë, do të njoftoheni edhe me shkrim.

Mirupafshim të hënën, në orën 11:00.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve